FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 81

Tiranë – E enjte, 8 maj 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 7.5.2025	Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar.....	11603
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 7.5.2025	Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar.....	11603
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 10.4.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 555, datë 20.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 233, datë 17.6.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-797, datë 2.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.....	11603

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 7.5.2025

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8668, DATË 23.10.2000, "PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 14/4, të ligjit nr.8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar, pas fjalës "... vendbanim ..." shtohen fjalët "... brenda dhe ....".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

AKT NORMATIV
Nr. 5, datë 7.5.2025

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, "PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 9/5, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar, pas fjalës "... vendbanim ..." shtohen fjalët "... brenda dhe ...".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 17, datë 10.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 10.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 38 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Gjonmarkaj, përfaqësuar nga avokat Ndre Molla, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 555, datë 20.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 233, datë 17.6.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-797, datë 2.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 35 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 3, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 432, pika 1, shkronjat "a"

dhe "b", 435, 441, pika 1, shkronja "ç" dhe 442, pika 1, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Aleksandër Gjonmarkaj (kërkuesi), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Më datë 23.6.2013 janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera edhe në qytetin e Lezhës, ku për këtë qëllim ishte ngritur dhe funksiononte Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 13 *(KZAZ nr. 13)*. Kërkuesi ka qenë me detyrë sekretar i kësaj KZAZ-je. Me përmbylljen e procesit zgjedhor, më datë 25.6.2013 materialet zgjedhore, procesverbalet e rezultatit të qendrave të votimit *(QV),* janë dërguar nga kryetarja e KZAZ-së nr. 13 dhe kërkuesi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *(KQZ)*. KQZ-ja ka konstatuar se për 10 QV-të, tabelat e rezultateve ishin fotokopje të vulosura me vulën e KZAZ-së nr. 13, që sipas rregullit mbahej dhe administrohej nga kërkuesi. Për këtë arsye KQZ-ja në miratimin e rezultatit përfundimtar për këtë KZAZ, me vendimin nr. 701, datë 10.7.2013, i është referuar bazës elektronike të të dhënave, krijuar nga të dhënat që ishin dërguar në kohë reale nga ajo KZAZ.

2. Ky vendim është kundërshtuar nga dy subjektet kryesore politike (Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Socialiste e Shqipërisë (*PS*)). Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve fillimisht nga KQZ-ja dhe më tej nga Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ky i fundit ka vendosur përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 701, datë 10.7.2013 të KQZ-së dhe rinumërimin e votave pranë atij kolegji. Referuar të dhënave të rinumërimit në 10 QV-të, të cilat kanë rezultuar ndryshe nga rezultati fillestar, KQZ-ja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë *(prokuroria)* për komisionin e KZAZ-së nr. 13.

3. Prokuroria, pas përfundimit të hetimeve, ka dërguar çështjen për gjykim duke i akuzuar të gjithë anëtarët e KZAZ-së nr. 13 dhe kërkuesin për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve", të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal *(KP),* të kryer në bashkëpunim. Gjatë zhvillimit të procesit në shkallë të parë, me gjykim të zakonshëm, fillimisht është bërë ndarja e çështjes penale lidhur me një nga të pandehurit GJ.GJ. dhe vazhdimi i gjykimit për të pandehurit e tjerë. Më tej, më datë 7.7.2017 prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes penale për 6 të pandehurit e tjerë pjesë e komisionit dhe vazhdimin e gjykimit vetëm për kërkuesin për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve". Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e datës 7.7.2017.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 555, datë 20.10.2017, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve", duke e dënuar përfundimisht atë me 3 vjet burg, konvertuar në shërbim prove për 3 vjet, si dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 3 vjetësh. Ajo gjykatë ka arsyetuar se nga tërësia e provave ka rezultuar e provuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale, pasi ka qenë detyrë e tij funksionale të administronte procesin zgjedhor referuar nenit 34 të Kodit Zgjedhor. Sipas saj, ka rezultuar i provuar edhe fakti se kërkuesi ka zëvendësuar tabelat origjinale me fotokopje me korrigjime, të cilat i ka vulosur me vulën e njomë të KZAZ-së nr. 13. Gjithashtu, kryerja e veprës penale, sipas asaj gjykate, provohet edhe nga fakti se tabelat e dorëzuara nga kërkuesi janë të ndryshme me të dhënat e administruara në kohë reale nga KQZ-ja lidhur me rezultatin e numërimit në KZAZ-në nr. 13. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shpalljen e tij të pafajshëm.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 233, datë 17.6.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 555, datë 20.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se

vendimi i shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe në prova dhe se është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas gjykatës, pretendimi i kërkuesit për mosvënien në dispozicion të akteve shkresore të administruara si prova nuk qëndron për sa kohë ato i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në një procedurë gjykimi të zakonshëm. Edhe pretendimi se numërimi është bërë nën dhunën e simpatizantëve të subjektit politik, PS-së, nuk e shkarkon kërkuesin nga përgjegjësia penale për sa kohë që ai nuk e ka referuar asnjëherë këtë fakt në organet kompetente, ndërkohë që provat e kërkuara nga ai për t'u marrë synonin të vërtetonin faktin se ai e ka kryer veprën në kushtet e presionit dhe dhunës. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-797, datë 2.5.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi me argumentin se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kolegji Penal, ndër të tjera, ka arsyetuar se gjykata e apelit ka analizuar dhe ka dhënë përgjigje të argumentuar për të gjitha pretendimet e kërkuesit. Sipas atij kolegji, janë të pambështetura argumentet e mbrojtjes lidhur me pavlefshmërinë e akteve të administruara, duke qenë se nuk ka pasur cenim të të drejtave të kërkuesit referuar nenit 34 të KPP-së. Gjithashtu, kërkuesi është njohur me përfundimin e hetimeve dhe aktet e fashikullit të gjykimit, aktet e marra gjatë hetimit paraprak i janë njoftuar të gjykuarit dhe mbrojtësit në përfundim të hetimeve, duke u dhënë mundësinë e kundërshtimit të tyre në gjykatë. Kolegji Penal, po ashtu, referon te neni 129 i KPP-së, i cili përcakton se pavlefshmëritë relative ngrihen nga palët në afatin e përcaktuar nga vetë dispozita.

7. Më datë 21.8.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 19.9.2024. Më datë 27.11.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Kolegji i Gjykatës më datë 6.12.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1 *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1 *Parimit të paanshmërisë,* pasi nga ana e gjykatave të faktit ka pasur një sjellje të dukshme të njëanshme në favor të organit të akuzës.

8.1.2 *Parimit të barazisë së armëve, si dhe të së drejtës për mbrojtje efektive,* pasi dy gjykatat e faktit i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur prova në proces, si prova shkresore ashtu edhe me dëshmitarë, si dhe nuk kanë bërë të mundur njohjen me aktet e dosjes penale si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjykimit, fakte këto që e bëjnë hetimin të pavlefshëm. Këto gjykata nuk kanë pasur si qëllim të jepnin drejtësi, por kanë favorizuar dukshëm akuzën. Të gjitha kërkesat për provat janë refuzuar nga gjykata pa dhënë një arsye bindëse. Nëpërmjet paraqitjes së dëshmitarëve do të vërtetohej fakti se veprimet e kryera nga ana e tij ishin bërë në kushtet e nevojës ekstreme. Refuzimi për të marrë provat e kërkuara nga ai në proces përbën një shkelje të rëndë procedurale dhe kushtetuese, e cila i ka kufizuar atij edhe të drejtën për mbrojtje efektive.

8.1.3 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke qenë se pretendimet kishin lidhje me shkeljen e procedurës dhe zbatimin e gabuar të ligjit material.

8.1.4 *Së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* pasi hetimi dhe gjykimi i çështjes së tij, në mënyrë të qëllimshme për të mbuluar të vërtetën, ka zgjatur 11 vjet.

8.2 Parimi i barazisë përpara ligjit, pasi dukshëm nga ana e gjykatave janë favorizuar të pandehurit e tjerë në proces, të cilët janë edhe ata të implikuar në veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, duke u shpallur të pafajshëm.

9. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

9.1 Për pretendimin për *cenimin e parimit të paanshmërisë* kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që lidhen me testin subjektiv, i cili kërkon të vlerësohet bindja ose interesi personal i gjyqtarit në çështjen konkrete. Po ashtu, nuk janë sjellë prova që lidhen me testin objektiv, i cili

analizon nëse gjyqtari ka siguruar garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për anshmërinë e tij.

9.2 Për pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe së drejtës për mbrojtje efektive* rezulton se procesi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, duke u dhënë palëve mundësinë e plotë për të debatuar për çdo provë që i është nënshtruar gjykimit. Sipas të dhënave të pasqyruara në aktet e sjella nga kërkuesi dhe fashikujt hetimorë rezulton se kërkuesi është njoftuar për akuzën dhe ka pasur mundësi të njihet me provat, fakt i vërtetuar me procesverbalin e njohjes së tij me aktet. Gjithashtu, gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të shqyrtojë dhe të debatojë për provat, gjë që provohet nga procesverbalet e seancave, ndërkohë që edhe gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk ka pasur shkelje në këtë aspekt. Si përfundim, gjykatat kanë analizuar në mënyrë të plotë provat e administruara gjatë ekzaminimit të plotë të tyre në kushtet e gjykimit të zakonshëm dhe kanë dhënë vendime të bazuara në prova e në ligj dhe të argumentuara mbi bazën e tyre, pa shkelur asnjë nga dispozitat ligjore në fuqi gjatë administrimit të gjykimit në ngarkim të tij.

9.3 Për pretendimin për *pretendimin se Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë,* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur me relacionin e relatorit në dhomën e këshillimit dhe pasi ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, çka e bën vendimin e dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë plotësisht legjitim. Gjithashtu, argumenti në mbështetje të këtij pretendimi nuk është i natyrës kushtetuese, pasi ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, i cili, për nga natyra e tij, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës.

9.4 Për pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit,* rezulton se për rastin në shqyrtim u janë krijuar mundësi të barabarta të gjitha palëve në gjykim. Gjykatat i kanë dhënë mundësi kërkuesit të paraqesë pretendimet e tij dhe të ofrojë prova të reja, të cilat, pasi janë administruar i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Mbi bazën e këtyre provave dhe provave të tjera të administruara gjatë procesit gjyqësor, gjykatat kanë bërë vlerësimet e veta dhe kanë krijuar bindjen për një vendimmarrje të drejtë. Gjithashtu, argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton në aspektin formal që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, ndërsa në aspektin substancial që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha shkallët e gjykimit, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet*

nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi në ankimin e tij ka pretenduar ndër të tjera, cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm,* pasi hetimi dhe gjykimi i çështjes së tij, në mënyrë të qëllimshme ka zgjatur 11 vjet.

14. Për sa u takon kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni në fuqi parashikon mjete juridike (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Dispozitat procedurale të sipërcituara nuk parashikojnë shprehimisht mjete të veçanta për kohëzgjatjen e procesit në tërësi, por vetëm për kohëzgjatjen e procesit në secilën prej fazave dhe shkallëve të gjykimit. Në këtë kuptim, edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procesit jo vetëm që vlerësohet në lidhje me kohëzgjatjen tërësore të procedurave, por, nga ana tjetër, ndikon drejtpërsëdrejti në këtë drejtim. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

15. Bazuar në këto standarde kushtetuese, Gjykata evidenton se kërkuesi ka pretenduar kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit në tërësinë e tij si në hetim, ashtu edhe në gjykim, ndërkohë që nuk rezulton që në ndonjë fazë të caktuar, si të hetimit, ashtu edhe të gjykimit në të tria shkallët e gjyqësorit, ai t'i jetë drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konstatimin e hetimit ose gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas neneve 399/6 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

16. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, konkretisht për cenimin e parimit të paanshmërisë, të barazisë së armëve dhe mbrojtjes efektive, si dhe të barazisë përpara ligjit, Gjykata evidenton se kërkuesi i ka parashtruar ato në formë dhe përmbajtje në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Ndërkohë që për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore, duke qenë se lidhet me vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se për këto pretendime kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 2.5.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 21.8.2024, nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Prandaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimeve të paanshmërisë, të barazisë së armëve, të mbrojtjes efektive të barazisë përpara ligjit, si dhe së drejtës për t'u dëgjuar, të cilat hyjnë në juridiksionit e Gjykatës.

19. Për pretendimin se është cenuar *parimi i paanshmërisë*, kërkuesi ka parashtruar se nga ana e gjykatave të faktit ka pasur një sjellje të dukshme të njëanshme në favor të organit të akuzës. Ndërkohë, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që lidhen me testin subjektiv, i cili kërkon të vlerësohet bindja ose interesi personal i gjyqtarit në çështjen konkrete. Po ashtu, nga ana e tij nuk janë sjellë prova që lidhen me testin objektiv, i cili analizon nëse gjyqtari ka siguruar garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për anshmërinë e tij.

20. Në jurisprudencën e Gjykatës e drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal

të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i kërkuesit është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar *(shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Bazuar në këto standarde kushtetuese, në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë ose argument kushtetues për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatave që kanë shqyrtuar çështjen e tij si në aspektin subjektiv, ashtu edhe në atë objektiv. Vetëm fakti se gjykatat kanë pranuar akuzën e ngritur nga prokuroria, nuk mund të provojë *a priori* se procesi penal i zhvilluar nga organet e drejtësisë, sipas kompetencave të tyre kushtetuese, është i njëanshëm. Për këtë arsye, ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

22. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *barazisë përpara ligjit,* me argumentin se janë favorizuar të pandehurit e tjerë në proces, të cilët janë edhe ata të implikuar në veprën penale të falsifikimit. Prokuroria e Përgjithshme lidhur me këtë pretendim ka prapësuar se të gjitha palëve në gjykim u janë krijuar mundësi të barabarta. Gjykatat i kanë dhënë mundësi kërkuesit të paraqesë pretendimet e tij, të paraqesë prova të reja, të cilat, pasi janë administruar i janë nënshtruar debatit gjyqësor, mbi bazën e të cilave si dhe provave të tjera të administruara gjatë procesit gjyqësor, gjykatat kanë bërë vlerësimet e veta dhe krijuar bindjen për një vendimmarrje të drejtë. Gjithashtu, sipas subjektit të interesuar, argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Referuar standardit të mësipërm dhe nisur nga argumenti i parashtruar nga kërkuesi, Gjykata vëren se në thelb pretendimet kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, pasi mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, të harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke qenë se pretendimet kishin lidhje me shkelje të procedurës dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur me relacionin e relatorit, në dhomën e këshillimit, ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, prandaj ka vendosur mospranimin e rekursit, çka e bën vendimin e dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë plotësisht legjitim. Gjithashtu, argumenti në mbështetje të këtij pretendimi nuk është i natyrës kushtetuese, pasi ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, i cili, për nga natyra e tij, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës.

26. Gjykata vëren se referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, e cila njihet edhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave

Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit gjyqësor. Ndërkohë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, në fazën e dytë çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit, mbi bazën e dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve në raste përjashtimore, të parashikuara nga neni 437, pika 1, i KPP-së *(shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar në mënyrë konstante se shqyrtimi i rekursit nga Gjykata e Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, bazuar në dispozitat procedurale të lartpërmendura, sipas të cilave shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotësonte kriteret për shqyrtimin e tij në seancë gjyqësore. Kjo do të thotë se shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji procedural. Për rrjedhojë, lidhur me këtë pretendim Gjykata vlerëson se vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit është i pamjaftueshëm për të mbështetur pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar.

28. Nisur nga sa më lart, në vijim, Gjykata do të analizojë pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të barazisë së armëve lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive

29. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe të së drejtës për mbrojtje efektive, pasi dy gjykatat e faktit i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur prova në proces, si prova shkresore, ashtu edhe me dëshmitarë, si dhe të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes penale si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit, fakte këto që e bëjnë hetimin të pavlefshëm. Këto gjykata, sipas tij, nuk kanë pasur si qëllim të jepnin drejtësi, por kanë favorizuar dukshëm akuzën, pasi të gjitha kërkesat në lidhje me provat janë refuzuar nga gjykata pa dhënë një arsye bindëse. Nëpërmjet paraqitjes së dëshmitarëve do të vërtetohej fakti se veprimet e kryera nga ana e tij ishin bërë në kushtet e nevojës ekstreme. Kërkuesi, po ashtu, thekson se refuzimi për të marrë provat e kërkuara nga ai në proces përbën një shkelje të rëndë procedurale dhe kushtetuese, e cila i ka kufizuar atij edhe të drejtën për mbrojtje efektive.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se procesi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, duke u dhënë palëve mundësinë e plotë për të debatuar për çdo provë që i është nënshtruar gjykimit. Sipas të dhënave të pasqyruar në aktet e sjella nga kërkuesi dhe fashikujt hetimorë rezulton se kërkuesi është njoftuar për akuzën dhe ka pasur mundësi të njihet me provat, fakt i vërtetuar me procesverbalin e njohjes së tij me aktet. Gjithashtu, gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të shqyrtojë dhe të debatojë për provat, gjë që provohet nga procesverbalet e seancave, ndërkohë që edhe Gjykata e Apelit Shkodër ka konfirmuar se nuk ka pasur shkelje në këtë aspekt. Si përfundim, gjykatat kanë analizuar në mënyrë të plotë provat e administruara gjatë ekzaminimit të plotë të tyre në kushte e gjykimit të zakonshëm dhe kanë dhënë vendime të bazuara në prova e në ligj dhe të argumentuara mbi bazën e tyre, pa shkelur asnjë nga dispozitat ligjore në fuqi gjatë administrimit të gjykimit në ngarkim të tij.

31. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar. Bazuar në këto parime, gjykatave i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të

barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 21, datë 20.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata. Këto kërkesa kushtetuese janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim është theksuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal mund të cenohet nëse refuzohet kërkesa e mbrojtësit për thirrjen e dëshmitarëve. Megjithatë, i akuzuari për të mbështetur pretendimin se i është cenuar e drejta e mbrojtjes për këtë shkak, duhet të bëjë të besueshme se pyetja e dëshmitarëve ishte e domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën. Nëse gjykatat e zakonshme çmojnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për thirrjen e dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjatë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson. Në këtë kuptim, në kontekstin e rrethanave të çdo çështjeje të veçantë, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë procesit gjyqësor ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur realizimin e së drejtës së mbrojtjes dhe, për pasojë, zhvillimin e procesit në mënyrë të drejtë *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 7, datë 28.2.2000 të Gjykatës Kushtetuese).*

34. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi gjatë procesit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm ka pretenduar, se: (i) nuk është njohur me aktet hetimore të prokurorisë si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit, si dhe se (ii) gjykatat e faktit nuk kanë pranuar provat me dëshmitarë dhe shkresore të kërkuara prej tij. Prandaj, bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, si dhe në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata do të analizojë nëse gjykatat e zakonshme, gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, kanë bërë të mundur që ai të njihet me provat e organit të akuzës, si dhe duke mos pranuar disa prej provave të kërkuara gjatë procesit gjyqësor i kanë cenuar atij parimin e barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, në kuptim të zhvillimit të një gjykimi të drejtë.

35. Gjykata konstaton fillimisht se, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështja është gjykuar me ritin e gjykimit të zakonshëm, procedurë kjo që u jep mundësinë palëve të debatojnë lidhur me çdo provë. Për shkakun e parë të pretenduar nga kërkuesi, Gjykata konstaton se nga fashikujt hetimorë dhe ata gjyqësorë, të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, rezulton se më datë 25.7.2014 nga prokurorët e çështjes kërkuesit i është komunikuar akuza, akt ky ku janë të pasqyruara të gjitha veprimet hetimore dhe provat mbi të cilat është bazuar kjo akuzë. Gjithashtu, në po të njëjtën datë rezulton se kërkuesi është pyetur në cilësinë e të pandehurit (ka kërkuar të japë shpjegime pa praninë e avokatit) lidhur me ngjarjen, duke pasur mundësi të japë shpjegime për rrethanat dhe faktet e çështjes penale në ngarkim të tij. Në përfundim të komunikimit të akuzës dhe marrjes së deklarimeve, kërkuesit i është dhënë mundësia të njihet me aktet e dosjes, fakt i provuar me procesverbalin përkatës. Gjithashtu, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme, Gjykata konstaton se shumica e akteve hetimore

janë akte të prodhuara nga KZAZ-ja nr. 13, ku ai vetë ai ka qenë sekretar, për rrjedhojë ka marrë pjesë në hartimin e tyre.

36. Gjykata vëren se edhe gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të njihet dhe të debatojë për provat, qofshin këto dëshmi ose prova të tjera. Ky fakt mbështetet edhe nga procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 23.3.2017, 27.4.2017, 26.5.2017, 7.6.2017 dhe 20.6.2017, të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në këto seanca nga ana e asaj gjykate janë shqyrtuar provat shkresore dhe janë pyetur dëshmitarët e çështjes (të thirrur nga organi akuzës) nga gjykata, si dhe nga palët. Konkretisht, gjatë këtyre seancave ajo gjykatë ka pyetur 8 shtetas në cilësinë e dëshmitarëve, të cilët kanë kryer detyrën e numëruesit në KZAZ-në nr. 13, si dhe 3 shtetas të tjerë në cilësinë e të bashkëpandehurve. Për më tepër, Gjykata vëren se seanca e datës 7.6.2017 është shtyrë në mënyrë që palët të njihen me të gjithë praktikën shkresore të administruar, me qëllim realizimin sa më efektiv të mbrojtjes. Gjithashtu, ky pretendim i kërkuesit ka qenë objekt kontrolli edhe i Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila nuk ka konstatuar të meta lidhur me procesin e gjykimit në shkallë të parë, duke konfirmuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e kërkuesit për mosnjohjen me provat e procesit penal në ngarkim të tij nuk janë të bazuara.

37. Për sa i takon shkakut të dytë, pra pretendimeve të kërkuesit që lidhen me (mos)marrjen e provave të tjera gjatë gjykimit, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 23.3.2017 kërkuesi ka kërkuar thirrjen e disa dëshmitarëve (vëzhgues të OSBE-së dhe vendas të paspecifikuar), me të cilat ai pretendonte të provonte dhunën psikologjike të ushtruar ndaj tij, si dhe kryerjen e ekspertimit grafik të tabelave të rezultateve të votimit për të provuar se nuk ishte autor i veprës penale të falsifikimit. Sipas kërkuesit, aktet ishin plotësuar nga kryetarja e KZAZ-së dhe më tej grupe kriminale prezente në ambientet e KZAZ-së e kishin detyruar atë (dhe anëtarët e tjerë të komisionit) të nënshkruante e vuloste aktet kundër vullnetit të tij, sikurse ishte provuar gjatë gjykimit edhe nga dëshmitarë të tjerë. Lidhur me thirrjen e dëshmitarëve nga ana e gjykatës së shkallës së parë, fillimisht kërkuesit i është kërkuar të paraqiste listë të detajuar me emrat dhe adresat e dëshmitarëve të cilët kërkoheshin të thërriteshin, listë kjo që është paraqitur e padetajuar në seancën e datës 20.6.2017, me shkakun se nuk njiheshin gjeneralitetet e këtyre personave, por që mund të identifikoheshin nga vetë gjykata. Kjo e fundit po në atë seancë nuk ka pranuar kërkesat e kërkuesit lidhur me thirrjen e dëshmitarëve dhe kryerjen e ekspertimit grafik.

38. Gjykata konstaton se në vendimin e gjykatës së shkallës së parë nuk arsyetohet për shkaqet e mospranimit të kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, ndërkohë që gjykata e apelit në arsyetimin e refuzimit të kësaj kërkese ka vlerësuar se vërtetimi i faktit se ndaj kërkuesit ishte ushtruar dhunë psikologjike nuk mund të provohej me dëshmitarë, për sa kohë që kërkuesi kishte pasur të gjitha mundësitë të bënte kallëzimet përkatëse në organet e drejtësisë. Ndërsa për sa i takon kryerjes së ekspertimit grafik, në vendimin e shkallës së parë është arsyetuar se në rastin konkret vepra penale e falsifikimit rezulton e verifikuar për shkak të ndryshimit të rezultatit të votimit mes tabelave të rezultateve të dërguara në KQZ në kohë reale dhe atyre të dërguara KQZ-së në përfundim të procesit të zgjedhjeve. Për këtë arsye, ekspertimi grafik është konsideruar i panevojshëm nga ana e asaj gjykate. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër. Në lidhje me përgjegjësinë penale të kërkuesit të dyja gjykatat e faktit kanë arsyetuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale, pasi ka qenë detyrë e tij funksionale të administronte procesin zgjedhor referuar nenit 34 të Kodit Zgjedhor dhe ka rezultuar e provuar se kërkuesi ka zëvendësuar tabelat origjinale me fotokopje me korrigjime, të cilat i ka vulosur me vulën e njomë të KZAZ-së nr. 13. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

39. Çështjet që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet zgjedhore janë marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka vënë theksin në shqyrtimin efektiv të ankimeve individuale në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat zgjedhore, pasi kjo përbën një nga garancitë thelbësore të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Një shqyrtim i tillë siguron ushtrimin efektiv të të drejtave individuale për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, ruan besimin e përgjithshëm në administrimin e

procesit zgjedhor nga shteti dhe përbën një mjet të rëndësishëm në dispozicion të shtetit për të arritur përmbushjen e detyrimit të tij për të zhvilluar zgjedhje demokratike (*Namat Aliyev kundër Azerbajxhanit, 2010, §§ 81 e vazhdim; Uspaskich kundër Lituanisë, 2016, §93; Mugemangango kundër Belgjikës [DhM], 2020, § 69*).

40. Bazuar në këto konsiderata dhe në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se pavarësisht se kërkuesi gjatë procesit penal në ngarkim të tij, në ushtrim të garancive procedurale e kushtetuese lidhur me të drejtën e mbrojtjes së tij, ka kërkuar, ndër të tjera, edhe pyetjen e dëshmitarëve për të vërtetuar faktin se ai ishte detyruar të firmoste dhe vuloste tabelat nën kanosjen e përfaqësuesve të partive politike në garë, si dhe një akt ekspertimi për të provuar se ai nuk ishte autori i veprës penale të falsifikimit, gjykatat e faktit jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij, por edhe nuk kanë dhënë argumente bindëse në vendimet e tyre në lidhje me mospranimin e këtyre provave. Gjithashtu, në kushtet kur të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit nuk janë deklaruar fajtorë, gjykatat e faktit duket se nuk kanë kryer një hetim të plotë e gjithëpërfshirës në drejtim të përcaktimit të saktë të fakteve të çështjes, por janë bazuar në prezumime fakti, duke e vënë kërkuesin në një pozitë dizavantazhi në raport me akuzën, pra duke mos i dhënë mundësinë e deklarimit të tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen.

41. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se gjykatat e faktit, në përmbushje edhe të parimit të kontradiktoritetit, duhet të kishin dhënë arsye të mirargumentuara për refuzimin për marrjen e provave të kërkuara nga kërkuesi, duke qenë se ato mund të ndikonin në përcaktimin e rrethanave dhe fakteve të çështjes, të cilat, nga ana e tyre, janë determinante për identifikimin e elementeve të veprës penale. Thënë kjo, gjykatat e faktit jo vetëm nuk kanë kryer një hetim efektiv në funksion të evidentimit të krimeve zgjedhore, por nuk i kanë dhënë mundësinë kërkuesit për të realizuar një debat real me akuzën në drejtim të zbulimit të së vërtetës, pra për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, duke bërë që argumentet e organit të akuzës të prevalojnë mbi ato të kërkuesit.

42. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, duke vendosur mospranimin e rekursit nuk e ka korrigjuar këtë situatë, pavarësisht pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Në këtë mënyrë, shkelja procedurale në raport me pasojat që kanë ardhur për kërkuesin (deklarimi fajtor i tij) duket se ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes, duke ia bërë atij të pamundur realizimin e së drejtës së mbrojtjes, si dhe duke vënë gjithashtu në dyshim në këtë mënyrë zhvillimin e një gjykimi të drejtë. Prandaj, Gjykata çmon se gjykatat e faktit dhe më tej Gjykata e Lartë nuk i kanë garantuar kërkuesit parimin e barazisë së armëve të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive.

43. Së fundmi, në kushtet kur referuar nenit 427 të KPP-së në raste të caktuara gjykata e apelit mund të përsëritë shqyrtimin gjyqësor, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohen vendimet nr. 233, datë 17.6.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2024-797, datë 2.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencën e saj lëndore. Kjo e fundit, duke u bazuar në kompetencat si gjykatë ligji dhe fakti, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesit dhe për t'iu dhënë përgjigje atyre në respektim të standardeve kushtetuese, si dhe duke plotësuar mangësitë dhe riparuar shkeljet e gjykatës së shkallës së parë.

44. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe të mbrojtjes efektive janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2024-797, datë 2.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 233, datë 17.6.2019, të Gjykatës së

Apelit Shkodër, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 10.4.2025.
Shpallur, më 2.5.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/05/08 16:51:07 +02'00'
a189f56aa96848f1aa055e6e23fb623a2025050816505991031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)